



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës
Opština Podujeva / Municipality of Podujeva



Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi

DATE/A:	14.02.2024
PËR:	Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komititetit
NGA:	Saranda Stublla, Drejtor
TEMA:	Plani i punës për vitin 2024
Nr.Pro:	08-401/04-011105/24

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2024

PËRMBAJTJA

1. Hyrja.....	3
2. Drejtoria.....	4
3. Sektori i Pronës.....	5,6
4. Sektori i Kadastrit.....	7,8
5. Sektori i Gjeodezisë.....	9
Përfundimi.....	10

HYRJJE

Institucionet shtetërore përmes përpilimit dhe hartimit të Planeve të Punës përcaktojnë para vetës dhe qytetarit objektivat dhe synimet që dëshirojnë të arrijnë në të ardhmën.

Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, bashkëpunon ngusht me drejtorit tjera komunale, me institucionet qendrore, Ministrin e Mjedist, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Agjencin Kadastrale të Kosovës.

Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi në vazhdimësi ka vendosur para vetës objektivat dhe synimet e realizueshme dhe imperative të cilat pastaj me profesionalizëm në përputhje me kushtet ligjore i ka trajtuar dhe realizuar.

Plani i Punës për vitin 2024, vë në pah objektivat e Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi të cilat synojnë përmirësimin dhe avancimin e shërbimeve gjeodezike dhe kadastrale, rritjen e shkallës së menaxhimit të pronës komunale, ofrimin e shërbimeve sa më të mira për palët, rritjen e të hyrave vetanake, mbrojtjen më të mirë të pronës publike dhe menaxhimin sa më efikasë të Regjistrit të paluajtshmërive.

Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi është e organizuar në këta sektorë:

1. Sektori i Pronës.
2. Sektori i Kadastrit,
3. Sektori i Gjeodezisë,

DREJTORIA

Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi është kompetente dhe përgjegjëse për organizimin e kapaciteteve kadastrale, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informativ mbi tokën dhe pronën në përgjithësi, planifikimin e rrjetit gjeodezik me pika të reja kontrolluese dhe themelimin e pikave kontrolluese.

Misioni primar i saj është krijimi i një ambienti ligjor në sferën e kadastrit dhe pronës komunale. Puna e drejtorisë orientohet që përmes matjeve kadastrale, sistemit informativ të tokës dhe regjistrave zyrtar të siguroj të drejtat mbi pronat e paluajtshme me krijimin e parcelave tokësore, ndërtesave si dhe përcaktimin e kufinjëve të tyre në komunën e Podujevës.

Qëllimi i drejtorisë është ofrimi i shërbimeve profesionale dhe shërbime të tjera subjekteve të ndryshme, përmirësimi i transferimit të tokës, menaxhimi i tokës komunale dhe efikasiteti në taksimin e tokave, evidencën për emërtimet e vendbanimeve, rrugëve, shesheve si dhe numrat e objekteve, shtëpive, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, etj.

Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi procedon shfrytëzimin e tokave komunale, zbaton vendimet e gjykatës për ndarje, bartje të pronësisë. Ajo ka bashkëpunim të mirë me institucionet qendrore, konkretisht me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Agjencinë Kadastrale të Kosovës si autoritet qendror i menaxhimit të të dhënave kadastrale. Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ofron shërbime profesionale dhe shërbime të tjera në fushën e kompetencave dhe përgjegjësi të saj për subjektet e së drejtës dhe organeve shtetërore, dhe me një bashkëpunim të mirëfilltë arrijnë që ti realizojnë punët e caktuara.

Trajnimet e stafit profesional

Zhvillimi shoqëror dhe teknologjik ka ndikuar që materia e trajtimit të jetë më specifike. Andaj, me qëllim të arritjes së objektivave të drejtorisë, ne në bashkëpunim me Zyrën e Personelit planifikojmë pjesëmarrjen e stafit profesional në trajnimet e organizuara nga Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe institucionet tjera relevante.

SEKTORI I PRONËS

Sektori për Pronë është përgjegjës të kujdeset për: procedurat e shpronësimit të tokave në pronësi private për interesat e përgjithshme shoqërore; procedurat e deekspropimit, gjegjësisht nulimit të aktvendimeve të plotfuqishme rreth shpronësimit në rastet kur plotësohen kushtet ligjore; mbrojtjen e të dhënave pronësore, ku bartës i së drejtës së shfrytëzimit është Kuvendi Komunal; procedurën administrative lidhur me uzurpimet arbitrare; evidencën e lëndëve të uzurpimeve; nxjerrjen e aktvendime, konkluzione lidhur me kërkesat e parashtruara, etj.

Objektivat e Sektorit të Pronës

Nr.r	Objektivat	Procedura	Burimi	Mbikëqyrësi	Zbatuesi
1	Të hyrat e qerasë nga shfrytëzimi i tokës komunale	E rregullt	Legjislacioni në fuqi, Vendimi i Kuvendit Komunal, Kontrata e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale	Kryetari i Komunës, Kuvendi Komunal	DPKGJ
2	Uzurpimet	E rregullt	Legjislacioni në fuqi	Kryetari i Komunës	DPKGJ
3	Shpronësimi	E rregullt	Legjislacioni në fuqi, Vendimi i Kuvendit Komunal	Kryetari i Komunës, Kuvendi Komunal	DPKGJ
4	Arhivimi i dokumentacionit kadastral	E rregullt	Legjislacioni në fuqi	Kryetari i Komunës	DPKGJ
5	Shërbime tjera.				DPKGJ

Aktivitetet me të cilat realizohen objektivat gjenerale të Sektorit të Pronës

Të hyrat e qerasë nga shfrytëzimi i tokës komunale – Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë nga viti 2018 bënë inkasimin e të hyrave të qerasë nga shfrytëzimi i tokës komunale nga personat fizik dhe juridik të cilët ligjërisht e gëzojnë të drejtën e shfrytëzimit në pronat e paluajtshme komunale.

(Aktiviteti: Krijimi i Listës së shfrytëzuesve legjitim të pronës së paluajtshme komunale (tokë) duke u bazuar në Vendimet e Kuvendit Komunal dhe Kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale; Menaxhimi i kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale (tokës).

Uzurpimet janë posedim i paligjshëm i pronës së paluajtshme të komunës nga personat fizik apo juridik. (Aktiviteti: Azhurnimi i Listës së uzurpatorve, Njoftimi i uzurpatorve për lirimin e pronës së paluajtshme të komunës, Vendimi për lirimin e pronës së uzurpuar të komunës).

Shpronësimi është vepër e Organit Shpronësues (komunës) që përfshin: marrjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është në zotërim ose pronësi të një personi në një pronë të paluajtshme, ose krijimin e detyrueshëm të një servituti ose një të drejte tjetër të shfrytëzimit në pronën e paluajtshme. (Aktiviteti: Punët përgatitore për përcaktimin e pronës së paluajtshme për shpronësim, E drejta e kompensimit e pronarit të pronës së paluajtshme për shpronësim, Fillimi i procedurave të shpronësimit me vetiniciativë ose me kërkesë të palës, Pranimi i komenteve dhe dëgjimi publik, Vendimi Preliminar mbi Ligjshmërinë e Shpronësimit të Propozuar, Vendimi Përfundimtar për Shpronësim, Regjistrimi i vendimit të shpronësimit në kadastër).

Arhivimi i dokumentacionit kadastral - Ky dokumentacion kadastral ka rëndësi shumë të madhe, i cili i referohet, shpronësimeve, kompensimeve, nacionalizimeve, konfiskimeve etj., të asaj kohe. Duke vlerësuar rëndësin e tyre, drejtoria jonë do bëjë përpjekje të bëjë klasifikimin dhe sistemimin e tyre.

SEKTORI I KADASTRIT

Sektori për Kadastër është përgjegjës të kujdeset dhe regjistron pronën e paluajtshme në RDPP, zhvillon procedurat e regjistrimit sipas detyrës zyrtare, zhvillon procedurat e regjistrimit sipas kërkesës së palëve, korigjon regjistrin sipas procedurave, zbaton të gjitha dispozitat pozitive në fuqi lidhur me regjistrimin e pronës, azhurnon pronësin në bazë të dokumenteve të verifikuara dhe shënimeve të tjera nga dokumentacioni arkivor, azhurnon regjistrin e ndërrimeve të matjeve nga terreni, nxjerr Aktvendime dhe Çertifikata sipas ligjit mbi kadastërin dhe udhëzimeve administrative për kadastër, nxjerr Aktvendime dhe Konkluzione lidhur me kërkesat e palëve, koordinon punët dhe zbaton udhëzimet e Agjencisë Kadastral të Kosovës.

OBJEKTIVAT E SEKTORIT TË KADASTRIT:

Nr.r	Objektivat
1	Zhvillon procedurën e regjistrimit të pronës në regjistrin kadastral në përputhje me ligjet në fuqi, sipas detyrës zyrtare dhe kërkesave të palëve në bazë të
2	Azhurnon e regjistrin e pronën, në bazë të dokumenteve të verifikuara dhe shënimeve të tjera nga dokumentacioni arkivor si dhe regjistrin të ndërrimeve të mjeteve nga terreni
3	Përmirëson transferimin e tokës, menaxhimin e tokës shtetërore dhe efikasitetin në tatimin e tokave
4	Korigjimin e të dhënave personale në çertifikatën e pronësis dhe modifikim të KCID në Nr.Personal
5	Rexhistrimi i hipotekave, Lirimin e Hipotekave
6	Merr vendime mbi regjistrimin e servituteve, barrën tatimore, ngastrat e tatimit në pronë dhe shënimet lidhur me dorëzantë
7	Ofron shërbime rreth murembajtjes dhe klasifikimit të kulturave të tokës
8	Azhurnon pjesën grafike, në bazë të dokumenteve dhe matjeve të reja dhe i transformon me parametrat e dhëna për transformim
9	Verifikimin dhe azhurimi i dokumentacioni kadastral
10	Ofron shërbime për shënimet e digjitalizuara (dhënie e koordinatave në terren)
11	Korigjon regjistrin (RDPP) sipas procedurave dhe dispozitave ligjore në fuqi
12	Lëshon çertifikata për patundshmëri, sipas kërkesave
13	Nxjerr vendime për miratim ose refuzim të kërkesave
14	Përmirëson transferimin e tokës, menaxhimin e tokës shtetërore dhe efikasitetin në tatimin e tokave
15	Ofron shërbime për ndarjen e ngastrave dhe shënimin e kushtjeve në rastet e shpronësimeve
16	Nxjerr konkluzione për plotësimin e kërkesave të pakompletuara
17	Kryen edhe punë të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushë veprimtarisë së Drejtorisë

Aktivitetet me të cilat realizohen objektivat gjenerale të Sektorit të Kadastrit.

Rexhistrimi i ndryshimeve kadastrale do të bëhen pas: pranimit, shqyrtimit të kërkesave të palëve dhe pas nxjerrjes së aktvendimit për aprovimin e tyre në bazë të dokumenteve juridike që janë relevante, rexhistrimi në kadastrë. (Përgjegjës sektori i kadastrit, afati 15 ditë, realizueshmëria 100%).

Rexhistrimi i njësive të reja në bazë të regjistrimit të ndryshimeve. (Përgjegjës sektori i gjeodezisë dhe sektori i kadastrit afati 15 ditë, realizueshmëria 100%).

Rexhistrimi sipas detyrës zyrtare i ndryshimeve në rexhistrin e palujtshmërive në bazë të vendimeve të ekspropriimit të cilat nuk janë zbatuar më herët. (Përgjegjës sektori i gjeodezisë, sektori pronësor juridik dhe sektori i kadastrit afati 10ditë, realizueshmëria 100%).

Rexhistrimi i Kadastrit etazhor bëhet pas: pranimit, shqyrtimit të kërkesave të palëve dhe pas nxjerrjes së aktvendimit për aprovimin e tyre në bazë të dokumenteve juridike që janë relevante, rexhistrimi i banesave apo lokaleve afariste. (Përgjegjës sektori i gjeodezisë dhe sektori i kadastrit, afati 15 ditë, realizueshmëria 100%).

Rexhistrimi dhe lirimi i hipotekave dhe ngarkesave të tjera në SIKTK, pas: pranimit, shqyrtimit të kërkesave të palëve dhe pas nxjerrjes së aktvendimit për aprovimin e tyre në bazë të dokumenteve juridike që janë relevante për rexhistrinë kadastrë. (Përgjegjës sektori i kadastrit afati 6 ditë, realizueshmëria 100%).

Bashkpunimi ndërsektorial arrihet në bashkrendimin e punëve mes tre sektorve i cili do të rezultoj me ngritjen e efikasitetit në përmbushjen e kërkesave të palëve.

SEKTORI I GJEODEZISË

Deklarata e misionit:

Sektori i Gjeodezisë është përgjegjës për përpunimin e të dhënave në grafikë, ndarjen, bashkimin e ngastrave kadastrale të proceduara nga kërkesa e palëve, përpunimin e skicave të ndarjeve për ndërtesa, banesa dhe njësive kadastrale si tokave, rivelimin e sipërfaqeve të ndërtesave, identifikimin e ngastrave kadastrale, mirëmbajtjen e kalsifikimit dhe kulturave të tokës, rindërtimin e zonave kadastrale të Komunës së Podujevës në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

Kryen edhe punë të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushë veprimtarisë së Drejtorisë.

PËRFUNDIMI

Ky plan i punës jep një përmbledhje të aktiviteteve të planifikuara për përmbushjen e objektivave kryesore të parapara për vitin 2024, gjithashtu gjatë këtij viti do të vazhdojmë me praktiken e raporteve periodike, të cilat do të jenë si një tregues mbi realizimin e planit të punës për këtë vit.

Drejtori i DPKGJ:

Saranda Stublla